


Franco Purini

Të Kompozosh Arkitekturën





Franco Purini

Të kompozosh arkitekturën

Përshtati në shqip
Llazar Kumaraku

Autor: Franco Purini

Titulli origjinal:

Comporre l'architettura

Publikuar për herë të parë nga *Gius. Laterza & Figli*, ©2000, Roma-Bari.

Original ISBN 88-420-6154-9

Përkthyes: Llazar Kumaraku

Redaktor letrar: Keti Sula, Arlon Liko

Përgatitur për botim dhe dizajn:

Ermal Hoxha

Kopertina: Llazar Kumaraku

Imazhi në kopertinë:

Franco Purini, *Classificazione per sezioni di situazioni spaziali*, 1968.

Këshilltarë shkencorë:

Daniela Kavaja, Sotir Dhamo,

Etleva Dobjani, Ermal Hoxha.

Editorë: Besnik Aliaj, Sotir Dhamo,

Dritan Shutina

Botues: POLIS_PRESS

© copyright për versionin në shqip:
Universiteti POLIS.

Është i ndaluar riprodhimi, qoftë edhe
pjesor, i bërë me çfarëdolloj mjeti,
përfshi këtu edhe fotokopjen për
përdorim të brendshëm apo didaktik.
Është i ligjshëm fotokopjimi vetëm për
përdorim personal nëse nuk dëmton
autorin. Çdo fotokopje që pengon
blerjen e një libri është e paligjshme
dhe sulmon mbijetesën e një mënyre të
transmetimit të dijes. Kush fotokopjon
një libër, kush vë në dispozicion
mjetet për ta bërë atë, apo edhe kush
favorizon në kryerjen e kësaj praktike,
vepron në dëm të kulturës dhe kryen
një vjedhje.

ISBN: 978-9928-4459-3-3

Për *Luigi-n, Giulio-n, Alice-n, Guido-n*
Augusto-n, Maria Celeste-n

FALËNDERIME TË AUTORIT: “Comporre l’architettura” është një përmbledhje e leksioneve që unë kam zhvilluar në IUAV të Venecias, nga viti 1994 deri në vitin 1999. Tematikat që shfaqen këtu, janë diskutuar me studentët e laboratorit të projektimit dhe me *Roberta Albiero, Fulvio Ferretto, Alessandro Golfetto, Raffaella Laezza, Francesco Menegatti, Dina Nencini, Alberto Pavesi, Nicola Ricciardi, Valter Tronchin, Sarah Zezza*, të cilët kanë qenë bashkëpunëtorë në mësimdhënie dhe për këtë motiv i falënderoj pa masë. Një tjetër falënderim shkon për *Gianni Contessi, Adriano Cornoldi, Francesco Dal Co, Vittorio Gregotti, Francesco Tentori*, me të cilët kam diskutuar shumë herë temat që shfaqen në këtë libër gjatë ditëve të kaluara në Venecia. Falënderim i veçantë shkon për *Laura Thermes*, që prej shumë vitesh përfaqëson bashkëbiseduesen time ideale, këshillat e së cilës kanë qenë shumë të vlefshme edhe në këtë rast.

Parathënie e autorit për versionin në shqip

Një falënderim i singertë

Kur Llazar Kumaraku më komunikoi se kishte filluar përkthimin në shqip të librit *Comporre l'architettura* dhe më pas do ta botonte atë në vendin e tij, ndjeva një emocion të fortë. Më erdhi mirë dhe mendova se ishte e rëndësishme që idetë e mia të arkitekturës të shprehura në këtë vëllim të vogël, që u botua për herë të parë në vitin 2000, në të cilin trajtohen tema nga leksionet që kam mbajtur në IUAV (Istituto Universitario di Architettura di Venezia), ku kam punuar si profesor nga viti 1994 deri në vitin 2002, ende mund të thonë diçka mbi profesionin tonë, për arkitektët e sotëm si dhe ata të së ardhmes që janë duke studiuar në fakultetet e Arkitekturës në Tiranë. Shqipëria është një vend kaq i afërt me Italinë po aq sa, për shumë aspekte, i largët dhe misterioz dhe, nga sa di, me një peizazh ende të paprekur, të mbushur me një ndjenjë të fuqishme mbi origjinën. Ideja se vizioni im i arkitekturës, i zhvilluar në shumë vite mësimdhënieje në Reggio Calabria, në Romë, në Venecia apo dhe në vende të tjera, mund të jetë i dobishëm për një shtet që është duke u futur me hapa të shpejtë dhe me rezultate të mira në ciklin e gjerë dhe të nxituar të globalizimit, ka ndikuar pozitivisht tek unë. Disa nga librat e mi janë përkthyer në Spanjë, në Portugali, në Korenë e Jugut; katalogët e ekspozitave të mia kanë dalë në Shtetet e Bashkuara, në Angli, në Brazil dhe në Venezuelë, por “Të kompozosh arkitekturën” në gjuhën shqipe

është një risi pozitive që më jep shumë kënaqësi. Në njëfarë mënyre është sikur të ishte botuar për herë të parë.

Kam takuar Llazar Kumarakun kur ai ishte student në Fakultetin e Arkitekturës në Valle Giulia. Pata mundësinë të vlerësoj vëmendjen e tij të thellë dhe të sigurtë për arkitekturën, dhuntinë e tij intelektuale dhe artistike të natyrshme, interesin e tij për mënyrat se si bëhen zgjedhjet në fushën e projektimit arkitektonik dhe urban. Një projekt, ai e koncepton si një njësi, gjithmonë të zhytur brenda një dialogu tematikash komplekse dhe, në mënyrë të natyrshme shumë krijues, në një sistem ekzistues të gjurmëve të vendbanimit, të cilat së bashku formojnë një palinsest të pafund. Së fundmi, ndjeshmëria e tij ndaj dimensionit të peizazhit më dukej nga një anë instinktive, dhe nga ana tjetër frut i një përpunimi kulturor të duruar dhe frymëzuar. Një falënderim të sigurtë ndaj tij për punën që ai ka bërë dhe, mbi të gjitha, për idenë që libri im të jetojë një sezon të ri dhe të ndryshëm. Ideja që kam për Llazar Kumarakun më bën të shpresoj se ai do të vazhdojë mësimdhënien, pasi ka një talent të lindur për të përcjellë njohuritë arkitektonike. Njohuri në të cilat marrëdhënia mes arkitekturës dhe qytetit duhet të ketë një rol kryesor, që sot për fat të keq është, pothuajse, plotësisht e mohuar nga ajo që po ndërtohet nëpër botë. Shpresoj që duke iu drejtuar atyre që do të kenë vullnetin dhe kohën për të lexuar fjalët e mia, t'i interpretojnë ato në një mënyrë progresive dhe të avancuar, duke u dhënë kuptime të reja. Për çdo autor, një libër është si një qenie e gjallë, e cila përballet me faza të ndryshme gjatë ekzistencës së saj. Duke u përkthyer

në shqip, libri “Të kompozosh arkitekturën” është gati të hedhë një tjetër hap të udhëtimit të tij tashmë të gjatë, në të cilin ai do të takojë një realitet që do t’i hapë perspektiva teorike dhe kritika të reja, të cilat me siguri do të rinovojnë tezat që ai propozon, duke i bërë akoma më të qarta disa pjesë të përmbajtjes së tij që ende nuk janë tërësisht të eksploruara.

Franco Purini

Romë, 09.07.2018

Parathënie nga përkthyesi

Franco Purini lindi në “Isola del Liri” në vitin 1941. Fëmijërinë e tij e kaloi në periferinë e Romës në kontakt të drejtpërdrejtë me rrënojat e Romës antike dhe me ndërtimet e lagjeve të reja të financuara nga shteti. Janë kujtimet e fëmijërisë së kaluar midis antikes dhe të resë, të shkuarës dhe të ardhmes, midis historisë dhe utopisë, midis traditës dhe inovacionit, që formojnë jetën personale dhe profesionale të Purini-t. Studimet e larta i kreu në Fakultetin e Arkitekturës Valle Giulia në Romë, duke i përfunduar ato me një temë të udhëhequr nga Ludovico Quaroni. Më vonë, bashkëpunoi me Maurizio Sacripanti-n dhe Vittorio Gregotti-n. I ndodhur, gjithmonë, midis idesh antagoniste që e kanë shoqëruar në formimin e tij, Purini zgjedh të mos përfshihet në ndonjërin prej tyre. Me punën e tij, ai kërkon të ndërtojë territore dialogjike midis kundërshtive ku hibridizohen e shkuara me të tashmen dhe të ardhmen, e vjetra me të renë, atopikja me topiken, atektonikja me tektoniken, racionalja me irracionalen, tradicionalja me inovacionin dhe utopinë. Në këtë kuptim, Franco Purini kërkon të ndërtojë një hapësirë të re, ku kërkimi teorik dhe praktika arkitektonike tejkalojnë kundërshtitë tipike që përshkuan shekullin e shkuar duke tentuar të krijojë territore të reja shprehëse gjuhësore.

Në Valle Giulia nisi karrierën si pedagog gjatë viteve '80 të shekullit të shkuar. Në vitet '90, zhvendoset në Venecia ku jep mësim në IUAV dhe në fillim të këtij

shekulli rikthehet sërish në Romë, ku për gati dhjetë vjet do të mbajë katedrën e kompozimit arkitektonik dhe urban, sërish në Valle Giulia. Aktualisht, është profesor emeritus në Kompozim Arkitektonik dhe Urban në Universitetin “Sapienza”, në Romë, që prej vitit 2015.

Purini është anëtar i “Accademia delle Arti del Disegno” në Firenze dhe i “Accademia Nazionale di San Luca” në Romë. Në vitin 2013 i është dhënë nga Presidenca e Republikës Italiane “Diploma di Medaglia d’oro di Benemerito della Scuola, della Cultura e dell’Arte”. Në vitin 2016 nderohet me medaljen e artë të karrierës nga “Triennale di Milano”.

Vepra e Purinit ndahet midis kontributit teorik që arkitekti ka dhënë në shkrimet e pafundme mbi arkitekturën dhe në projektet e realizuara në bashkëpunim me Laura Thermes nisur që prej vitit 1966. Për t’u theksuar është kontributi i madh që Franco Purini jeppër atë që është quajtur “Architettura Disegnata” ku renditet si një ndër eksponentët kryesorë. Vizatimet e tij të shumta paraqesin “imazhe që rrjedhin nga një akt i pastër fantazie, të cilat edhe pse me këtë origjinë, të ndërmjetme midis ëndrrës dhe kujtimit të diçkaje të humbur, arrijnë shpeshherë të tregojnë pjesët më të fshehta dhe shpesh më ndriçuese të realitetit”.

Ndër librat e tij më të rëndësishëm mund të rendisim: *Luogo e progetto; L’architettura didattica; Sette paesaggi; La misura italiana dell’architettura; Franco Purini. Le opere, gli scritti, la critica; Dal progetto. Scritti teorici di Franco Purini (1966-1991); La città*

uguale. Scritti scelti sulla città e il progetto urbano (1966-2004); La città nuova: Italia-y-26 invito a VEMA: il Padiglione italiano alla 10ª Mostra Internazionale di Architettura dhe Comporre l'Architettura, i cili vjen tashmë në shqip me titullin *Të kompozosh Arkitekturën*, pas një pune të gjatë të zhvilluar për gati pesë vite, me shkëputje të mëdha, për të reflektuar mbi temat e trajtuara në libër.

Në thelb, libri trajton një sërë temash që kanë qenë argument i përhershëm i kritikës arkitektonike dhe këto tema i analizon nën lентen e transformimeve të mëdha që po pëson bota aktuale. Në shkrimin e tij, autori kërkon të ndërtojë një seri me konstante arkitektonike, të cilat mund të shërbejnë si tema studimi për profesionistë të tjerë dhe, njëkohësisht, mund të jenë mjete teoriko-praktike për të ndërtuar arkitektura të mundshme.

Purini mund të cilësohet, qartësisht, një arkitekt neomodern, dhe kjo për dy motive; i pari, sepse format arkitektonike të propozuara prej tij mbartin ngarkesën morfologjike tipike të arkitekturës moderne, të cilat kanë pranuar gjendjen e anonimatit si një cilësi e vetëdijshme, dhe i dyti bazohet mbi qëndrimin që arkitekti mban ndaj arkitekturës. Faktikisht, arkitekti italian ka përvetësuar një shprehje të Edoardo Persico-s që e sheh arkitekturën si “substancë e gjërave të shpresuara”. Këtë mësim, që i vjen nga modernizmi, ai e bën leitmotiv të të gjithë veprës së tij. Kjo qasje e pozicionon arkitektin në një periudhë të saktë të historisë së arkitekturës, e cila është ajo e modernizmit por, autori, vigjilent ndaj transformimeve që ka pësuar bota e arkitekturës

në shekullin e fundit dhe i vetëdijshëm për gjendjen aktuale të saj, propozon sjellje ndaj arkitekturës dhe hapësirës urbane, të cilat tejkalojnë pikat kritike të modernizimit, siç është për shembull indiferenca ndaj vendeve. Kjo indiferencë nuk është tipike vetëm e arkitekturës moderne, por edhe e asaj postmoderne të ditëve të sotme, e cila ende prodhon hapësira dhe arkitektura, derivate të një konsumi gjithëpërfshirës, të cilat sjellin një homologim të botës. Në shkrimet dhe në veprat e tij, Purini, i ndërgjegjshëm për këto transformime, propozon zgjidhje që respektojnë diferencat, duke i konsideruar ato si elemente që pasurojnë botën e arkitekturës.

Libri është i ndarë në rreth pesëdhjetë e pesë paragrafë, ku pas një hyrjeje që prek gjendjen aktuale dhe çështjet emergjente, trajtohen temat e kompozimit, projektimit, dritës, hapësirës, materialeve, vizatimit, ideve-instrumente dhe tipologjisë në arkitekturë. Argumente këto që gjithmonë kanë qenë thelbi i disiplinës së arkitekturës. Trajtimi i temave është empirik dhe kërkon të vendosë në fokus të vëmendjes së profesionistëve temat e përhershme të arkitekturës pa pasur frikë t'i ballafaqojë ato me situatën që jetojmë.

Versioni origjinal nuk përmban shënime sqaruese, ndërsa në versionin shqip, përkthyesi, në bashkëpunim me autorin, ka shtuar disa sqarime, të cilat janë të nevojshme për të plotësuar kuptimin e versionit të përkthyer.

Si përfundim, ky libër nuk do të ishte i mundur pa dëshirën, vullnetin e spikatur dhe mbështetjen e

dhënë nga Bordi Themelues i Universitetit POLIS, i cili ka besuar në vlerën e këtij libri që në fillimin e kësaj aventure. Kanë dhënë kontribut të pamasë, për të cilin u jemi shumë mirënjohës, kolegët Ermal Hoxha, Etleva Dobjani, Sotir Dhamo. Gjithashtu, i jemi mirënjohës edhe Franco Purini-t, i cili pranoi, me kënaqësi dhe entuziazëm, shkrimin e një paragrafi hyrës, dhe në mënyrë të palodhur u është përgjigjur të gjitha paqartësive dhe pyetjeve që kemi pasur gjatë përshtatjes në versionin shqip. Një falënderim i veçantë shkon për redaktoren letrare, Keti Sula, e cila me përkushtimin që i dedikoi redaktimit, bëri që libri të jetë sot më i qartë. Falënderimi i fundit shkon për Daniela Kavaja, e cila me punën e kryer në hapat e fundit para botimit të librit, bëri që e gjithë puna të qartësohet mbi përmbajtjen e temave që prek edhe pse teksti, për shkak të natyrës konceptuale dhe teorike, shfaqet i ndërlikuar në tërësinë e tij.

Llazar Kumaraku

Korrik 2018

Hyrje

Libri është një përpjekje për të shpalosur disa këndvështrime rreth temës së kompozimit arkitektonik. Trajtimi i çështjeve të mëposhtme nuk synon të jetë shterues, nuk kërkon as të hyjë në spekulime filozofiko-arkitektonike, edhe pse në shumë pjesë të këtij libri, mënyra e të shkruarit të tekstit të çon tërthorazi në atë drejtim. Kështu, në faqet në vijim, shpalosja e temave dhe e instrumenteve të arkitekturës është qëllimisht empirike; herë e përsëritur, herë e ndërprerë, ndoshta edhe e patrajtuar plotësisht; shpesh e thjeshtëzuar deri në skematizëm. Kjo mënyrë përpiket të krijojë një sërë ndërlidhjesh në raport me çështjet, të cilat nuk mund t'i shmangim nëse duam të projektojmë ndërtesa, qytete apo peizazhe. Kjo përpjekje përshkohet natyrshëm nga eksperiencia e autorit, por në fakt qëllimi është shndërrimi i kësaj eksperience personale në një linjë sa më përgjithësuese, në mënyrë që ajo të tejkalojë interesat personalë.

Një vëmendje e veçantë i është dedikuar përballjes me situatat dhe kushtet e reja që arkitektura po kalon në periudhën aktuale, e cila karakterizohet nga transformime të mëdha që mund të përfshijnë

të gjithë planetin. Gjithsesi, ky vëzhgim mbi aktualitetin bashkëkohor nuk synon të hedhë poshtë *parimet e përhershme* të procesit të kompozimit, për t'i zëvendësuar ato me një sërë paradigماش të përkohshme.

Për një kohë të gjatë, arkitektura perëndimore është bazuar në reflektimin mbi rrënojën duke e konsideruar atë si vendi i përplasjes midis lindjes dhe vdekjes së artefaktit. Nga soditja e mbetjeve të një ndërtese, e cila nuk shfaqte më formën që kishte në fillimin e ekzistencës së saj duke u bërë, kështu, protagoniste e një enigme magjepsëse dhe afatgjatë, arkitekti nxirrte jo vetëm elemente përcaktuese për karakterin përfundimtar të artefaktit, por edhe një sërë mbresash figurative.

Kohët e fundit "*plaga ballkanike*"¹ i tregoi botës imazhin e rrënojave të reja. Përkrah rrënojave historike si ato të gurëve të shkëputur të Urës së Mostarit, apo mbetjet e djegura të Bibliotekës së Sarajevës, në ekranet e televizorëve u panë edhe volumet e shkatërruara dhe të nxira të ndërtesave të Beogradit, shumë prej të cilave ishin të ndërtuara në dhjetëvjeçarët e fundit. Në këtë mënyrë, siç kishte ndodhur disa vite më parë në Bejrut dhe Bagdad, arkitektura moderne tregoi një pamje që më përpara vetëm arkitektura antike e kishte shfaqur. Kështu, muret e thërrmuara dhe të nxira, trarët e thyer me hekurat e shtrembëruar, si të ishin vena gjaku të këputura, soletat e transformuara në grumbuj lastrash çimentoje të thyera dhe të mbivendosura në kodra të valëzuara, apo të kthyera në grumbuj

¹ Autori i referohet këtu lufëtrave të zhvilluara në Ballkan gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shek. të XX.

mbetjesh me pluhur pa asnjë ngjashmëri me atë që kishin qenë më parë, flasin gjuhën tragjike, të përsëritur shumë herë, të shkatërrimit. Këto imazhe shkaktojnë plakjen e menjëhershme të arkitekturës moderne, e cila ka dashur gjithmonë, nëpërmjet një riformulimi gati femënor, të jetë mjeti mbartës i një rinie të përjetshme.

Në këtë pikë, duhet thënë se arkitektura është shpresë dhe ky tekst e pohon këtë aspekt në çdo pjesë të tij. Këtë e thekson edhe Edoardo Persico kur, duke perifrastuar një mendim të Shën Palit mbi besimin, shkruan se arkitektura është “*substanca e gjërave të shpresuara*”. Kjo shpresë, do të ishte e kotë nëse nuk do të shoqërohej nga vullneti për të ndryshuar botën, që siç ndodh shpesh, mund të jetë një pritje pa rezultat, por fisnike. Ajo, gjithashtu, rrjedh nga një karakter thelbësor i arkitekturës, i cili është ai i të qenit *e domosdoshme*, ose siç thotë Le Corbusier, i të qenit *vetë kushti* që popujt të jetojnë të lumtur. Sot, për të bërë arkitekturë duhet të jemi të udhëhequr nga ky kusht *domosdoshmërie*. Kjo duhet të jetë mënyra e të menduarit, të vizatuarit dhe të ngriturit të ndërtesave, qyteteve dhe peizazheve. Kjo mënyrë duhet të vazhdojë me bindje më të madhe dhe me instrumente më të mira pas shkatërrimeve që ky shekull përjetoi dhe me të cilat donte të prezantonte mijëvjeçarin e ri, nëpërmjet një skenari vezullues, ku teknika shkatërron teknikën. Midis këtyre shkatërrimeve, këto të fundit ishin të paralajmëruara nga *dekostruktivizmi*, profeci shqetësuese e rënies së rendit të botës, të ndarë në dy blloqe², e përfaqësuar

² Autori i referohet blloqeve politike, më saktë atij Lindor dhe Perëndimor, ndarja e të cilëve karakterizoi shekullin e shkuar.

në arkitekturë nga kompozimi i bazuar në një ekuilibër rreptësisht të drejtë deri në konformizëm, i cili kishte zgjatur për disa dhjetëvjeçarë. Për këtë motiv, sot duhet filluar nga një projekt *rindërtimi disiplinor* i cili, duhet të jetë i menduar dhe bindës. Ky rindërtim disiplinor duhet të shmangë çdo iluzion *palingjetik*³, çdo mënyrë të shpejtë tekniçiste, çdo tundim *demiurg*⁴ dhe, po ashtu, edhe çdo përpjekje për të shkuar drejt imazhit të pastër, pa u trembur dhe pa u nënshtruar nga modat.

³ Iluzioni *palingjetik* është ai që të shtyn drejt besimit se diçka mund të niset gjithmonë nga e para dhe krijimi bëhet mbi një *tabula rasa* pa marrë parasysh ndikimet që mund të vijnë nga jashtë.

⁴ Sjellje ku arkitekti identifikohet me zotin dhe mendon se mund të bëjë gjithçka nga e para dhe fjala e tij nuk mund të vihet në diskutim. Sipas Platonit, demiurgu ishte krijuesi i universit.

Të kompozosh arkitekturën

NJË KONSTATIM

Në ditët e sotme është më e thjeshtë të njohësh arkitekturën sesa në të kaluarën, qoftë edhe në atë të pak viteve më parë. Tani udhëtohet më tepër dhe mund të arrihen lehtësisht vende që më parë konsideroheshin të largëta. Shkollat e arkitekturës, nëpërmjet programeve europiane të formimit, të cilat parashikojnë shkëmbime me fakultete të ndryshme, organizojnë udhëtime studimore dhe studentëve u ofrohen më tepër mundësi për të vizituar qytete dhe monumente. Për më tepër, edhe shkrimet mbi arkitekturën po lulëzojnë më shumë se kurrë. Vetëm në Itali botohen më shumë se njëqind revista. Gjithashtu, publikohen libra cilësorë nga pikëpamja tipografike, të ilustruar me fotografi të bukura me ngjyra, të shoqëruar me materiale grafike të kuruara shumë mirë. Lexuesit janë në kontakt me vizatime të sakta dhe me printime të mira të planimetrive, pamjeve, prerjeve, të detajeve të ndërtimit dhe shumë informacioneve rreth çdo aspekti të procesit projektues ose edhe të fazave të ndryshme të realizimit të një vepre. Le të mendojmë

se, vetëm rreth njëzet vite më parë⁵, arkitektura njihej nëpërmjet librave apo revistave falë pak fotografive bardh e zi, të cilat jepnin një shfaqje të zbehtë të ndërtesës dhe që nuk arrinin dot të shpjegojnë cilësitë e objektit arkitektonik. Kjo na bën të kuptojmë lehtësisht mundësitë e reja që janë sot në dispozicion të procesit të njohjes, për shembull, ngjyrat e shumë ndërtesave moderne ishin të panjohura. Një vepër e njohur riprodhohej gjithmonë nga e njëjta pikë vështrimi duke anashkaluar pamje, mbase edhe më domethënëse, dhe shpeshherë imazhet e hapësirës së brendshme, nuk arrinin në asnjë mënyrë të tregojnë vlerën e dritës që i përshkonte, si në rastin e zgavrimeve të hijëzuara të shtëpive *wrightiane*. Po ashtu, edhe konteksti ku ndërtesa pozicionohej, nuk dokumentohej pothuajse asnjëherë. Në ditët e sotme ekzistojnë rindërtime virtuale të arkitekturave të njohura, simulime shumë të sofistikuara që janë me interes të veçantë, sidomos për rastet kur këto vepra janë zhdukur apo janë në gjendje rrënoje, siç është rasti i *Fori Imperiali* në Romë, apo të tjera që kanë ngelur thjesht në fazën e projektit. Kështu, sot është e mundur të kryesh *udhëtime* tejet magjepsëse në disa vepra të porealizuara të Le Corbusier-it; në *Danteum* të Giuseppe Terragni-t, të cilëve jemi në gjendje t'u vlerësojmë hapësirat e brendshme, që tregohen me besnikëri absolute, gati të njëjtë me atë që mund të kishin nëse do të ishin realizuar, përfshi këtu edhe qiellgëvishtësinë një milje të lartë të Frank Lloyd Wright-it.

Kjo mundësi njohjeje e drejtpërdrejtë duket sikur mund të transformojë çdo arkitekt në një Adriano të

⁵ Libri *Comporre l'architettura* është publikuar për herë të parë në Itali nga shtëpia botuese "Laterza" në vitin 2000. Në momentin që autori shkruan *...njëzet vite më parë...* i referohet viteve '80 të shekullit të XX.

mundshëm. Ashtu si perandori romak, i rijetëzuar nga Marguerite Yourcenar në librin që me të drejtë është bërë i famshëm, i cili gjatë udhëtimeve kishte zgjedhur një seri me arkitektura që i afroheshin më shumë ndjeshmërisë së tij, për t'i bashkuar ato më vonë në *Villa Adriana* në një *koleksion* prestigjioz, ashtu edhe arkitekti bashkëkohor, mbi bazën e asaj që ka parë personalisht, mund të krijojë një muze personal ideal. Ky muze përbëhet nga ndërtesa që i kanë lënë mbresa, të cilave ka mundur t'i vlerësojë nga afër aftësinë e tyre për të ndërtuar kontekstin dhe për t'u vetë-ndërtuar si sekuencë domethënëse e materialeve dhe e hapësirave që e rrethojnë. Në këto *udhëtime studimore*, që kanë për model *Udhëtimin në Lindje* të Le Corbusier-it, arkitekti kërkon identifikimin e tij me një gjeografi ideale që ai do të riprodhojë në një vend të ndryshëm të tokës.

Por, nuk është flori gjithçka që shkëlqen. Eksperienca e drejtpërdrejtë e një shumëllojshmërie ndërtesash mund të duket gabimisht zëvendësuese e një studimi të strukturës formale të tyre, i karakterizuar ky nga analiza e thellë e planimetrive, prerjeve, dhe e vendosjes në kontekst. Përveç kësaj, informacioni i tepërt, bashkuar me shpejtësinë me të cilën pasohen të rehat, mund të eliminojnë *distancën kritike* që kushdo që kompozon duhet të vendosë gjithmonë midis punës së tij dhe ngjarjeve që në njëfarë mënyre e përfshijnë. Si përfundim, një njohje e gjerë dhe e shumëfishtë e arkitekturës mund të çojë lehtësisht në një relativizëm kritik të tepërt dhe që ka për rezultat një aftësi më të vogël për të kuptuar vlerat origjinale të veprave me të cilat ndërvepron. Pa marrë parasysh këtu faktin se informacioni i tepërt mund të provokojë një mbingopje të vërtetë, rezultat i së

cilës do ishte heqja dorë nga vazhdimi për të kuptuar ngjarjet që vijnë gjithmonë e me frekuencë më të madhe dhe me intensitet më të lartë.

Veç të tjerash, duhet shtuar se ky informacion shumë i gjerë nuk i përket të gjithë konteksteve kulturore, por vetëm atyre më të forta, të mbështetura në ekonomi të fuqishme, të cilat marrin pjesë në gjendjen e re të *globalizimit*. Për shembull, mjafton të kujtojmë se është Perëndimi që mbizotëron sferën informative dhe po ai që zotëron arkitekturën e realizuara në brendësi dhe në zonat e tij më të forta. *Qytetërimi arkitektonik* bashkëkohorë, si ato vendeve latino-amerikane, kanë qenë gjithmonë në hije. Si rezultat, puna e arkitektëve të mëdhenj, si ajo e venezuelasit Raul Villanueva apo argjentinastit Clorindo Testa, njihet shumë më pak nga sa meriton. Po ashtu, asgjë, ose fare pak mbërrin nga Lindja e Europës, nga Rusia apo India. Arkitektura afrikane është totalisht e panjohur, ndërkohë që vetëm ndonjë shkëlqim i rrallë ia del të mbërrijë në Europë nga Kina apo nga Australia e largët. Përveç kufizimeve të renditura, duhet thënë se informimi i gjerë dhe në kohë reale përbën padyshim një element pozitiv që konfiguron një projekt në fazë embrionale, mbase i nënkuptuar dhe i papërsosur, i një universalizimi të ri arkitektonik.

PARASHTRIME FILLESTARE

Të kompozosh, është si të luash shah, ku duhet menduar gjatë para se të bëhet lëvizja e parë, sepse nëse nuk bëhet ajo e sakta apo e duhura ose le të themi, nëse lëvizja nuk është pjesë e një numri të vogël alternativash të përputhshme me programin e


fiksuar, nevojitet të rifillosh nga e para. Të menduarit gjatë, shërben për të organizuar të dhënat funksionale dhe qëllimet formale në përfundime të vlefshme, të cilat transformohen në *ide udhëzuese* dhe kanë aftësinë të udhëheqin ciklin e projektit. Shpeshherë, talenti është armik i kësaj sjelljeje reflektive, e cila përfaqëson një fazë ku burimet krijuese të arkitektit përqëndrohen dhe lartësohen. Në këtë pikë do të ndërhyjë menjëherë vizatimi dhe roli i tij do të jetë përcaktues, duke bërë që zgjedhjet arkitektonike të manifestohen plotësisht dhe të tejkalojnë aludimet që ato shprehin në mendimin e pastër dhe në diskutimet verbale. Do të vijojë më vonë përpunimi i gjatë i *shprehjeve* kompozitive dhe teknike të projektit, në atë *kërkim të devotshëm* që Le Corbusier e vendosi në bazën e punës së arkitektit. Energjia që arkitekti zotëron, duhet kanalizuar, disiplinuar, *ndërtuar* dhe vënë në provë në pak, ose shumë pak tema. Vetëm nëse ngushtohet fusha tematike, duke punuar për shumë vite mbi të njëjtat probleme, mund të arrihen rezultate të vlefshme, që arkitektë të tjerë mund t'i përvetësojnë dhe t'i përmirësojnë. Për këtë arsye, talenti natyror është shpeshherë pengesë. Ai që fatmirësisht është i pajisur me talent, duhet në njëfarë mënyre ta refuzojë, madje ta *shkatërrojë*, për të ndërtuar nga mbetjet e tij një sjellje ndryshe, e cila duhet të jetë më e vetëdijshme dhe afatgjatë. Nëse vëzhgojmë me vëmendje rrugëtimin krijues të atyre që rinovuan gjuhët kompozitive kryesore, duke i zëvendësuar ato me gjuhë arkitektonike revolucionare, për shembull Francesco Borromini, Nicolas Ledoux, Frank Lloyd Wright, është e thjeshtë të verifikojmë se të gjithë këta zbulues *territoresh shprehëse* të reja, kanë vepruar mbi bazën e përdorimit të shumtë dhe të vazhdueshëm të imagjinatës formale

dhe të aftësive teknike duke i kanalizuar në metodologji të ndjekura në mënyrë maniakale, duke i lënë pak hapësirë improvizimit. Kjo ndodh edhe kur zgjidhjet e tyre duken të lindura në mënyrë instiktive dhe në të njëjtën kohë tërësisht të përfunduara. Ata që nuk kanë një sjellje të lindur ndaj arkitekturës, nuk duhet të ndihen të pafavorizuar. Talenti natyror, i cili përputhet me atë që zakonisht quhet *syri absolut*, analog me *veshin absolut* të muzikantëve, mund të zëvendësohet me talentin e përfituar nëpërmjet një ushtrimi që mundëson pajisjen me "*seste negli occhi*"⁶, siç do thoshte Michelangelo, ose më saktë me aftësinë për t'i dhënë kompozimit raportet proporcionale që ai kërkon. Me kalimin e viteve, kjo sjellje bëhet e natyrshme.

Nëse të kompozosh është si të luash një lojë shahu, gjendja shpirtërore për ta trajtuar është ajo që Charles Baudelaire ka përshkruar në trekëndëshin *qetësi, luks, kënaqësi e thellë e të shijuarit*. Kështu, ai që kompozon, duhet të jetë i qetë, por ama edhe vigjilent, i hapur ndaj impulseve të inteligjencës krijuese, i depërtuar nga një shpirt i saktësisë formale që nuk është llogaritje e saktë, por *përshtypje aluzive*⁷ e mençur dhe e çliruar nga çdo shqetësim. Arkitekti, i

⁶ Shprehja "*seste negli occhi*" tregon aftësinë për të matur raportet dhe proporcionet. Mund të përkthehet edhe "*të kesh syrin kompas*" dhe do të thotë që me kalimin e kohës, duke u ushtruar mbi instrumentet e kompozimit, arkitekti fiton automatikisht një aftësi për të matur hapësirën me shikim të parë.

⁷ Tri fjalët "qetësi, luks dhe kënaqësi", të marra nga Charles Baudelaire, tregojnë klimën ideale të shkrimit artistik. Me *përshtypje aluzive* të mençur, autori do të tregojë ato mënyra të gjuhës, të cilat nuk mund të shprehen me formula përshkruese, madje as edhe me saktësi teknike shumë specifike, por që lënë, gjithmonë, diçka misterioze, të nënkuptuar, të papërcaktuar tërësisht. Le të mendojmë, për shembull, për punën e Andrea Palladio-s, e cila shfaq gjithmonë interpretime të reja në çdo lexim.



1. Franco Purini, *Cercando una città*, 1997, bojë kine në karton,
40 x 40 cm

Indekset

Indeksi i emrave

- Aalto, Alvar, 50
Adriano, perandori, 4
Alberti, Leon Battista, 61, 188
Albiero, Roberta, VI
Argan, Giulio Carlo, 96, 173
Artaud, Antonin, 54
Asplund, Erik Gunnar, 173
Asnago, Mario, 78
Augé, Marc, 32, 162
Aymonino, Carlo, 174
- Balla, Giacomo, 73
Bandini, Micha, 172
Banham, Reyner, 150
Barbera, Lucio, 41
Barragan, Luis, 20, 82
Battisti, Emilio, 27
Baudelaire, Charles, 8, 54
Benevolo, Leonardo, 26
Benjamin, Walter, 157
Bibiena, Ferdinando Maria,
137
Bisogni, Salvatore, 163
- Boeri, Stefano, 27
Borges, Jorge Luis, 116
Borromini, Francesco, 7
Botta, Mario, 40
Bramante, Donato, 96
Burelli, Romano, 40
Burri, Alberto, 123
Borroughs, William, 118
- Cacciari, Massimo, 21
Cage, John, 80
Canella, Guido, 162
Caniggia, Gianfranco, 174
Cantafora, Arduino, 117
Castiglione, Baldassarre, 20
Cellini, Francesco, 82
Chemetov, Paul, 163
Cicerone, Marco Tullio, 176
Ciorra, Pippo, 27
Ciriani, Henri, 56, 163
Contessi, Gianni, VI, 114
Cook, Peter, 150
Cornoldi, Adriano, VI, 172
Costa, Lucio, 137

- Dal Co, Francesco, VI, 21
 D'Amato, Claudio, 40
 Dardi, Costantino, 50, 82
 D'Ardia, Giangiacomo, 117
 De Carlo, Giancarlo, 111
 De Chirico, Giorgio, 39
 De Fusco, Renato, 176
 Della Volpe, Galvano, 89
 Derossi, Piero, 28
 De Rubertis, Roberto, 120
 Diocleziano, perandori, 58
 Doesburg, Theo Van, 143

 Eisenman, Peter, 82, 95, 110
 Eyck, Aldo Van, 163
 Ezekeli, profeti, 64

 Ferretto, Fulvio, VI
 Fiorentino, Mario, 14
 Frampton, Kenneth, 40
 Freud, Sigmund, 53, 138
 Fuksas, Massimiliano, 150
 Fuller, Buckminster, 23, 150

 Gabetti, Roberto, 162
 Gandy, Joseph Michael, 66
 Gardella, Ignazio, 50
 Ghery, Frank, 111
 Gibson, William, 26, 186
 Gideon, Sigfried, 38, 164
 Golfetto, Alessandro, VI
 Gould, Stephen Jay, 21
 Grassi, Giorgio, 82
 Gregotti, Vittorio, VI, XI, 14, 26,
 82, 93, 163
 Gropius, Walter, 181

 Heidegger, Martin, 98
 Hejduk, John, 56

 Hermes, 160
 Hestia, 160
 Hilberseimer Ludwig, 23
 Hogarth William, 87

 Isola, Aimaro, 162

 Kahn, Louis, 45, 135, 175
 Kaufmann, Emil, 166
 Klein, Alexander, 172
 Kollhoff, Hans, 40
 Koolhaas, Rem, 27
 Kostantinidis, Aris, 83
 Krier, Leon, 118
 Krier, Robert, 116
 Kubrick, Stanley, 128

 Laezza, Raffaella, VI
 Le Corbusier, pseud. i
 Charles Eduard Jenneret,
 XIX, 4, 5, 7, 10, 20, 23, 40,
 45, 50, 54, 68, 93, 109,
 116, 143, 173, 181
 Ledoux, Nicolas, 7
 Leonardo Da Vinci, 113
 Leopardi, Giacomo, 54
 Lewin, Kurt, 134
 Libera, Adalberto, 52, 64, 82,
 143
 Libeskind, Daniel, 87
 Loos, Adolf, 70, 142
 Lynch, David, 186
 Lynn, Greg, 120
 Lyotard, Jean François, 22, 63,
 171

 Magnago Lampugnani,
 Vittorio, 27
 Maldonado, Tomas, 26

- Marti Aris, Carlos, 172
 Meier, Richard, 82
 Melograni, Carlo, 14
 Mendini, Alessandro, 143
 Menegatti, Francesco, VI
 Menna, Filiberto, 75
 Michelangelo Buonarroti, 8,
 86, 95, 165
 Mies van der Rohe, Ludwig, 40
 50, 82, 93, 95, 135, 144
 Mitchell, William J., 107
 Mondrian, Piet Cornelis, 85
 Moneo, Rafael, 82
 Monisteroli, Antonio, 82
 Moore, Charles W., 163
 Moretti, Luigi, 38, 43, 50, 82,
 134, 143
 Moschini, Francesco, 115, 117
 Muratori, Saverio, 52, 173, 174

 Natalini, Adolfo, 116
 Nencini, Dina, VI
 Neri, Gianfranco, 30
 Nicolin, Pierluigi, 27
 Niemeyer, Oscar Soares, 137
 Norberg-Schulz, Christian, 162
 Nouvel, Jean, 150
 Novelli, Gastone, 123

 Palladio, Andrea, 8, 21, 59
 Passi, Dario, 117
 Pavesi, Alberto, VI
 Perret, Auguste, 66
 Persico, Edoardo, XIII, XIX
 Piano, Renzo, 150
 Piero della Francesca, 144
 Pikionis, Dimitris, 52
 Piranesi, Giovan Battista, 54
 Plečnik, Jože, 52

 Polesello, Gianugo, 56
 Pollock, Jackson, 85
 Ponti, Gio, (Giovanni), 128
 Portoghesi, Paolo, 44, 162
 Pouillon, Fernand, 52
 Prati, Franz, 117

 Quaroni, Ludovico, XI, 14, 188

 Racine, Jean, 92
 Rashid, Hani, 120
 Renna, Agostino, 163
 Ricciardi, Nicola, VI
 Ridolfi, Mario, 52
 Rimbaud,
 Jean-Nicolas-Arthur, 54
 Rogers, Ernesto Nathan, 58
 Rossi, Aldo, 157, 162
 Roussel, Raimond, 53
 Rowe, Colin, 151
 Rudofsky, Bernard, 62
 Rykwert, Joseph, 109

 Sacripanti, Maurizio, XI, 164
 Sade, Donatien Alphonse
 François, ndryshe i quajtur
 markezi de., 54
 Solomon, mbreti i Izraelit, 64
 Samonà, Alberto, 163
 Samonà, Giuseppe, 163
 Sant'Elia, Antonio, 23
 Scarpa, Carlo, 50, 110, 142
 Schinkel, Karl Friedrich, 173
 Schwarz, Rudolf, 52, 83
 Scolari, Massimo, 117
 Secchi, Bernardo, 177
 Semerani, Luciano, 52, 162
 Semper, Gottfried, 142
 Shën Pali, apostull, XIX

Simmel, Georg, 104
 Siza Viera, Alvaro, 116
 Soane, John, 66
 Solà, Morales Ignasi de, 158
 Stendhal, pseud. i Henri Beyle,
 54
 Sterling, Bruce, 26, 186
 Stirling, James, 173

 Tafuri, Manfredo, 187
 Tentori, Francesco, VI, 184
 Terragni, Giuseppe, 4, 50, 82
 Terranova, Antonino, 27
 Testa, Clorindo, 6
 Thermes, Laura, VI, XII, 32,
 170
 Tronchin, Valter, VI

 Ugo, Vittorio, 178
 Ungaretti, Giuseppe, 92
 Ungers, Oswald Mathias, 82,
 93

 Vacchini, Livio, 40
 Valéry, Paul, 43
 Vattimo, Gianni, 23, 28
 Vender, Claudio, 78
 Venezia, Francesco, 82
 Venturi, Robert, 156
 Villanueva, Raul, 6
 Vinciarelli, Laretta, 118
 Virilio, Paul, 188
 Vitruvio Pollione, Marco, 33,
 48, 175, 178

 Warhol, Andy, 49
 Weber, Max, 176
 Wilde, Oscar, 142
 Woods, Lebbeus, 118

 Wright, Frank Lloyd, 4, 7, 15,
 23, 136, 146

 Yamasaki, Minoru, 165
 Yourcenar, Marguerite, 5

 Zandini, Mirko, 27
 Zevi, Bruno, 27, 38, 86, 121,
 134, 180
 Zezza, Sarah, VI
 Zoffoli, Paolo, 30

Indeksi i librit

Parathënie e autorit për versionin në shqip	VII
Parathënie për botimin në shqip	XI
Hyrje	XVII
Të kompozosh arkitekturën	1

Një konstatim, fq. 3 – Parashtime fillestare, fq. 6 – Një tjetër parashtrim, fq. 12 – Disa reflektime dhe një paralajmërim, fq. 15 – Ideja e projektit, moderniteti, perspektivat aktuale, fq. 21 – Çështje emergjente, fq. 34 – Të njohësh për të kompozuar, fq. 37 – Gjëndjet aktuale të kompozimit, fq. 40 – Analiza dhe njëkohshmëria, fq. 41 – Të kompozosh për të ndërtuar, fq. 43 – Disa aspekte të kompozimit, fq. 44 – Ndërtimi si vazhdim, fq. 57 – Projekti, fq. 60 – Projekti si ndërtim, fq. 61 – Projekti si kusht i detyrueshëm për arkitekturën, fq. 62 – Kohët e projektit, fq. 65 – Një tjetër aspekt i projektit, fq. 67 – Veçantia e ndërtimit në arkitekturë, fq. 68 – Një aspekt i veprës arkitektonike, fq. 72 – Një veçanti e arkitekturës, fq. 76 – Aspekte të leximit të një vepre arkitektonike, fq. 79 – Eksperienca e një arkitekture, fq. 81 – Forma arkitektonike, fq. 84 – Saktësia, fq. 89 – Matja, fq. 92 – Teknika, fq. 97 – Drita, materia, pesha,

fq. 98 – Materie dhe materiale, fq. 99 – Prezantimi, fq. 104 – Gërmimi, fq. 108 – Simulimi i kohës, fq. 109 – Vizatimi, fq. 111 – Një veçanti e vizatimit, fq. 118 – Vizatimi dixhital, fq. 119 – Shikimi i arkitektit, fq. 122 – Raporti me vendin, fq. 126 – Drita në kompozim, fq. 127 – Dy mënyra të të shfaqurit të dritës, fq. 129 – Një aspekt i dritës, fq. 130 – Drita e shkallëzuar, fq. 131 – Hapësira, fq. 132 – Dy modele strukturore të hapësirës, fq. 135 – Katër tipe hapësinore, fq. 137 – E jashtëmja dhe brendësia, fq. 139 – Dekorimi, fq. 140 – Dekorim dhe përsëritje, fq. 144 – Ndërtesa, fq. 147 – Ndërtesa antike dhe ndërtesa moderne, fq. 148 – Kopje dhe unike, fq. 153 – Ndërtimi, fq. 157 – Idetë-instrumente, fq. 158 – Të tjera ide-instrumente, fq. 166 – Tipi dhe arkitektura, fq. 169 – Shkalla, fq. 181 – Ndërtimi i përkatësisë, fq. 182 – Përfundime të përkohshme, fq. 185

Indeksi i emrave

193

